

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "G&R" SHPK

Sot me daten 20/01/2020, personat fizik :

1- GAZMENDI ALIAJ, i datelindjes 16/02/1976, i biri i Pajtim, lindur ne Delvine dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me I.D. personale H60216046O,
1- REDIAN PASHAJ, i datelindjes 23/12/1987, i biri i Luanit, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me I.D. personale I71223074M,

-ne perputhje me Ligjin Nr.9901 dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare", (me ndryshimet perkatese), vendosën krijimin e Shoqerise Tregtare me pergjegjesi te kufizuar, si me poshte :

Emerimi, Selia dhe Afati i Veprimtarise :

Neni 1

Te themelojnë Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte Person Juridik Shqiptar dhe veprimtaria e saj rregullohet nga kjo Kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi i Republikes se Shqiperise.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet "**G&R**" SH.P.K.

Neni 3

Shoqeria do te kete **SELINE** e saj në Tiranë, Tirane, Njesia Bashkiake nr.2, Sheshi Italia, Godina Air Albania Stadium, njesia C.3, Kati 0. (Perballe hyrjes se Hotel MAK Albania).

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj tregtar me AFAT TË PAKUFIZUAR. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne QKB.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

BAR, KAFE, RESTORANT, HOTELERI, TURIZEM.

Tregeti me pakice dhe shumice, import – eksport te pijeve, artikujve ushqimore dhe artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve.

Transporte te ndryshme.

Dhenie ambjentesh me qera.

Agjensi turistike dhe imobiliare

Shërbime të ndryshme dhe çdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj.



Neni 6

Shoqeria mund të çele filiale ,dege dhe perfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar, pasi të kete filluar aktiviteti i shoqërisë.

Neni 7

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 8

Kapitali Fillestar Themelues i Shoqërisë është 100.000 leke dhe u takon Ortakëve të saj Themelues. Kapitali Fillestar përbëhet nga 2-Dy pjesë me vlerë dhe përqindje përkatësisht si më poshtë :

1-GAZMENDI ALIAJ -1-një Pjesë me vlerë 50.000 Leke, me 50% pjesëmarrje në Kapital.
2-REDIAN PASHAJ -1-një Pjesë me vlerë 50.000 Leke, me 50% pjesëmarrje në Kapital.

Kur Shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave të marrin ortakët themelues.

Fitimi neto i realizuar nga Shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregtare etj. përfitohen prej ortakëve themelues të kësaj shoqërie.

Ortakët përballojnë humbjet e Shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar.

Në rast zmadhimi të Kapitalit Themeltar nepermjet shtimit të tij ortakët kanë të drejtën e rritjes së tij. Kapitali mund të rritet nga fitimi në natyrë, nga kontributet e ortakëve, nga kredite bankare etj.

Fitimet e Shoqërisë që rezultojnë pas miratimit të Bilancit Vjetor do të destinohen si më poshtë :

- Zmadhim Kapitali
- Fond Rezervë,
- Shpërblim për Ortakët e Shoqërisë.

Neni 9

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera vendase ose të huaja, edhe nëse ato nuk kanë të njëjtin objekt veprimtarie me të.

Neni 10

Shoqëria mund të krijojë filiale ose perfaqësi Brenda ose jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit ku ato krijohen.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakëve:

Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:

Neni 11

Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë në përputhje me Kontraten, Statutin dhe Legjislacionin në fuqi.

Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së Shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.

Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese së Ortakëve.

Të heq dorë nga shoqëria.



Heqja dore nga Shoqeria nuk e liron Ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

Te marre pjese ne organet e Shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tij ose vete.

Te emeruje dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Ortaku ka keto detyrime kryesore:

Te depozitoje kuoten e tij dhe kuotat suplementare ne perputhje me Kontraten dhe Statutin.

Te marre pjese ne administrimin e Shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.

T'i jape Shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.

Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te Shoqerise.

Ortaku ka te drejte te heqe dore nga Shoqeria, duke i njoftuar vendimin e tij Asamblese se Ortakeve ne rast shtimi te ortakeve 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.

Heqja dore nuk e liron Ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj Shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e Shoqerise ndaj Ortakut.

Ti jape Shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.

Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te Shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

Administrimi

Organi vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete **Asamble e Zakonshme** ose **Asamble e Jashtezakonshme**.

Administratori.

Neni 12

Veprimtaria operative e Shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem.

Administrator i Shoqerise "G&R" do te jete Z. GAZMENDI ALIAJ qe ne te njehet kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te Shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj.

Me miratimin e ortakeve mund te emerohen administratore dhe perfaqesuese te tjere te Shoqerise.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje **5 vjet**, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te Shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se Shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Administratoret pergjigjen individualisht ndaj Shoqerise apo te tretteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te shkaktuara per faj te tyre gjate administrimit te Shoqerise.



Mbyllja e Shoqerise:

Neni 13

Veprimtaria e Shoqerise pushon me propozim te Asamblese se Ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur Ortakët heqin dore nga Shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te Shoqerise (Kontrata, Statuti).

Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Kur Shoqeria likujdohet:

Neni 14

Asambleja e Ortakeve emerone Likuidatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne çastin e miratimit te ketij raporti te hartuar.

Komisioni i Likuidimit perbehet nga 1-nje ose 3-tre anetare.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te Shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre.

Te ardhurat cedohen ndermjet ortakeve ne perpjetim me kuoten e vene.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se Shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 15

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asamblea e Ortakeve.


Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te Shoqerise pasi tu jene bere pagesat likuidatoreve.

Dispozita te hollesishme per organizimin dhe funksionimin e kesaj Shoqerie percaktohen ne Statutin e Saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQERISE

GAZMENDI ALIAJ



REDIAN PASHAJ

